



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.917/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët Ferki Xhaferi kryesuese Rrustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelin e Sadije Bajgora Klinaku, kandidate për Kuvend Komunal në Komunën e Vushtrrisë, nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Vushtrrisë, paraqitur kundër vendimit me nr.2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021 për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 06.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet i pabazuar apeli Anr.917/2021 i datës 04.11.2021, i paraqitur nga Sadije Bajgora Klinaku, kandidate për Kuvend Komunal në Komunën e Vushtrrisë, nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Vushtrrisë, për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021 për Kuvendin Komunal, me të cilën ka kërkuar rinumërim të votave në Qendrat e Votimit QV 2702B, QV 2701B, QV 2702X, QV 2704B, QV 2707B, QV 2717B, QV 2710B, QV 2714B, dhe vendvotimet VV 2731B/01R, VV 2713B/01R, VV 2702B/03R dhe BM 227/001.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 04.11.2021, ka pranuar apelin Anr.917/2021 të paraqitur nga Sadije Bajgora Klinaku, kandidate për Kuvend Komunal në Komunën e Vushtrrisë, nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Vushtrrisë me të cilën pretendon se në Qendrat e Votimit QV 2702B, QV 2701B, QV 2702X, QV 2704B, QV 2707B, QV 2717B, QV 2710B, QV 2714B dhe në Vendvotimet VV 2731B/01R, VV 2713B/01R, VV 2702B/03R dhe votat e diasporës në vendvotimin BM 227/001 janë manipuluar votat e saj, andaj ka kërkuar nga PZAP që ta urdhëroj KQZ-në që të rinumroj fletvotimet në këto Qendra të Votimit dhe Vendvotime si në apel. Në mbështetje të pretendimeve të saj si provë ka bashkangjitur Formularët e Rezultateve të Kandidatëve.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pa bazuar

Nga shkresat e lëndës, rezulton fakti se apeli i parashtruar nga kandidatja për anëtare të Kuvendit Komunal në Vushtrri, Sadije Bajgora nga Subjekti Politik LDK, me të cilën kërkon rinumërim të votave në Qendrat e Votimit QV 2702B, QV 2701B, QV 2702X, QV 2704B, QV 2707B, QV 2717B, QV 2710B, QV 2714B, si dhe në Vendvotimet VV 2731B/01R, VV 2713B/01R, VV 2702B/03R dhe BM 227/001 është i pabazuar pasi që Paneli vlerëson se parashtruesja e apelit në mbështetje të pretendimeve të saj, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara siç pretendon në apelin e paraqitur, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, e në rastin konkret, paneli gjeti se pretendimet e apelueses nuk janë mbështetur në prova dhe fakte konkret por janë vetëm pretendime të supozuara dhe se këto pretendime për Panelin nuk janë të pranueshme.

Andaj, Paneli vlerësoi se apeli, nuk është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje gjatë numërimit të votave për kandidatin.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr.917/2021 më datën 06.11.2021



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.